

## **Hapet thirrja për aplikime për bursa në Universitetin Clermont Auvergne, për stafin akademik me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës në kuadër të Programit Erasmus + në Universitetin Clermont Auvergne, Francë.**

Në kuadër të Programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për mësimdhënie në Universitetin Clermont Auvergne në Francë, për stafin akademik me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës, për semestrin e dytë të vitit akademik 2021 - 2022.

<https://www.uca.fr/>

### **Llojet e mobilitetit:**

-Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie;

### **Fushat e shkëmbimit:**

- Gjuhë Frënge;

<https://www.uca.fr/>

### **Kohëzgjatja e bursave:**

- 5 ditë +2 ditët e udhëtimit;

Mobiliteti duhet të kryhet në periudhën shkurt – prill 2022.

### **Bursat përfshijnë:**

-Kompensimin për stafin (160 EUR në ditë për stafin);

-Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

| <b>DISTANCA E UDHËTIMIT</b><br>( <a href="http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm">http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm</a> ) | <b>Kompensimi</b> |
|--|-------------------|
| <b>Midis 100 dhe 499 KM</b>  | 180 EUR           |
| <b>Midis 500 dhe 1999 KM</b>   | 275 EUR           |
| <b>Midis 2000 dhe 2999 KM</b>  | 360 EUR           |
| <b>Midis 3000 dhe 3999 KM</b>  | 530 EUR           |
| <b>Midis 4000 dhe 7999 KM</b>  | 820 EUR           |
| <b>8000 KM ose më shumë</b>  | 1100 EUR          |

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni:

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)

## **Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik:**

- CV + Lista e publikimeve (në gjuhën frënge);
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën frënge);
- Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);
- Vetëdeklarim nëse keni kryer ose jo më parë mobilitet Erasmus+ (nëse po, ku);
- Plani i mobilitetit për mësimdhënie\*;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për Mësimdhënie klikoni në adresën:

[https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Mobility\\_Agreement\\_Training\\_outgoing-1.docx](https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Mobility_Agreement_Training_outgoing-1.docx)

\*Plani i Mobilitetit është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat, i cili është Koordinator i Institucional i Erasmus +.

Afati për aplikim: **24 Nëntor 2021**

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al).

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al).

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!